



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Shtojca 10

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

[Datë 11.07.2024]

Drejtuar: ANTIGONE RENTALS me NIPT L71611037J, adresa: Rruga “Mine Peza”, Pallati 1, Shk.1, Ap.4, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur, Mall.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF- 04713-05-14-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje automjet zjarrfikës për Drejtorinë e MZSH-së”, sasia: sipas shtojcës 6, afati: 45 (dyzet e pesë) ditë.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 26 datë 20 Maj 2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. START CO Shpk Numri i NIPT-it L11614001S

Vlera: 21’480’000 (njëzet e një milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) Lek.

2. ANTIGONE RENTALS Shpk Numri i NIPT-it L71611037J

Vlera: 22’500’000 (njëzet e dy milion e pesëqind mijë) Lek.

Njësia Administrative Nr.1, Lagjia 3, Sheshi “Liria”, Nd.1, tel & fax +355 52 2 /223 10, web: www.durres.gov.al, e- mail : info@durres.gov.al

* * *

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. START CO **NIPT L11614001S** *për arsytet e mëposhtme:*

- Për ofertuesin **START CO Shpk, me NIPT L11614001S**, me vlerë të ofertës 21'480'000 lek, Operatori START CO, paraqiti dokumentacionin e mesiperm ne daten 28.06.2024, dorezuar ne Bashkine Durres me nr. regjistri 5653, date 28.06.2024, dokumentacion i cili, sipas procesverbalit te inventarizimit te dates 03.07.2024, ka parregullsi, si edhe devijime dhe mospërputhje në vetëdeklarimet e tij sipas shtojces nr. 8, me konkretisht:

1. Nuk permbush pikën 2.2.3 te Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar ku citohet se *“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument)”*, pasi ofertuesi ka paraqitur ne SPE vertetimet e shlyerjes se taksave dhe tarifave vendore te Bashkise Tirane, Durres dhe Vore, dhe ne dosjen fizike ka paraqitur vetem vertetimin e shlyerjes se taksave dhe tarifave vendore te Bashkise Tirane.

2. Referuar dokumentacionit fizik te paraqitur nga ofertuesi, konstatohet mungesa fizike e dokumentacionit te vetedeklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, perkatesisht:

- Neni 26, pika 2.b) *“operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së”;*

- Neni 26, pika 2.d) *“operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi”;*

- Neni 26, pika 2.dh) *“operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së”;*

- Neni 26, pika 2.e) *“operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë”.*

Persa me lart, mungesa e dokumentacionit te konstatuar nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave bie ndesh me nenin 26, pika 6, ku citohet se *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: ANTIGONE RENTALS me NIPT L71611037J, adresa: Rruga “Mine Peza”, Pallati 1, Shk.1, Ap.4, Tiranë., se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: 22’500’000 (njëzet e dy milion e pesëqind mijë) Lek/totali i pikëve të marra [_____], është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.